



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

Nr.Prot 286

Tiranë, më 15/11/2023

VENDIM

Nr.63 datë 15.11.2023

PËR

PËR SHPALLJEN TË PAVLEFSHME TË VULËS EKZISTUESE TË KZF-FMD DHE PAJISJEN ME VULË TË RE PËR PËRDORIM NË PROCESIN ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET E ANËTARËVE TË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME PËR DHËNIEN E GRADËS SHKENCORE "DOKTOR" NË NJËSITË KRYESORE TË UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË, E NË VIJIM

Në bazë të Rregullores së Zgjedhjeve miratuar nga Senati Akademik i UMT-së me Vendimin nr.13, datë 12.02.2020 "*Për miratimin e Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese dhe komisionet e përhershme në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë"*, e ndryshuar, si dhe në kërkesën nr.prot 5, datë 09.11.2023, të Komisionit Zgjedhor të Fakultetit të Mjekësisë Dentare për pajisje me vulë dhe procesverbalin bashkëlidhur kësaj kërkesë, Komisioni Institucional Zgjedhor në mbledhjen e datës 13.11.2023,

VENDOSI:

1. Të shpallë të pavlefshme vulën e miratuar me Vendim të KIZ nr.3, datë 13.05.2020, për përdorim nga Komisioni Zgjedhor i Fakultetit të Mjekësisë Dentare, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë (gjurma 1), bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të pajisë me vulën e Kryetarit të KZF-FMD, të miratuar me Vendim të KIZ nr.3, datë 13.05.2020, për përdorim nga Komisioni Zgjedhor i Fakultetit të Mjekësisë Dentare, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë (gjurma 2), bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Të miratojë përdorimin e vulës së Kryetarit të KZF-FMD, për procesin zgjedhor të datës 20.11.2023, *Për zgjedhjen e Komisionit të Përhershëm për dhënien e gradës shkencore "Doktor" në nivel njësie kryesore, në të 3 (tri) njësitë në Universitetin e Mjekësisë,*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

Tiranë”, duke filluar nga data 13.11.2023 deri në përfundim të mandatit dhe veprimtarisë së Komisionit Zgjedhor të Fakultetit të Mjekësisë Dentare, të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

4. Ngarkohet Sekretariati i KIZ dhe Sekretariati i KZF – FMD të kryejnë procedurën e dorëzimit / marrjes në dorëzim të vulës së re në përputhje me Rregulloren e Zgjedhjeve.
5. Ngarkohet Kryetari i Komisionit Zgjedhor të Fakultetit të Mjekësisë Dentare për administrimin dhe përdorimin zyrtar të saj për vulosjen e dokumenteve sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, afishohet në mjediset e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, publikohet në faqen zyrtare të internetit të UMT dhe një kopje e tij i dërgohet KZF-FMD të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

KRYETAR
SILVANA BALA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

1. Fromati i vulës së miratuar me Vendim të KIZ nr.3, datë 13.05.2020, për përdorim nga Komisioni Zgjedhor i Fakultetit të Mjekësisë Dentare, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, shpallet e pavlefshme (gjurma 1)



2. Fromati i vulës Kryetarit të KZF-FMD, miratuar me Vendim të KIZ nr.3, datë 13.05.2020, për përdorim nga Kryetari i Komisioni Zgjedhor i Fakultetit të Mjekësisë Dentare, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, rikthehet për përdorim nga KZF-FMD (gjurma 2)

